

---

# **Analizë e Raportit Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin 2019**

---

*Analizë Politikash*

---

05/2020



# Analizë e Raportit Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin 2019

---

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillim i qëndrueshëm**

Publikimi: **Maj 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**National Endowment  
for Democracy**  
*Supporting freedom around the world*

Ky punim është publikuar me mbështetjen e National Endowment for Democracy. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

---

## **Përmbajtja**

Hyrje .....	2
Gjetjet nga raporti.....	3
Përfundime dhe rekomandime.....	7
Lista e Kontrollit me Elementet e Raportit .....	9

## Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) që nga fillimi i punës së tij, i ka ofruar ndihmë Kuvendit të Republikës së Kosovës në punën e tyre me agjencitë e pavaruara dhe Komisioneve respektive, ndërsa specifikisht Komisionit parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. INDEP-i konsideron që agjencitë e pavarura të themeluara dhe mbikqyrura nga Kuvendi janë organe shumë me rëndësi, prandaj edhe raportimi i tyre në Kuvend duhet të jetë proces gjithëpërfshirës dhe transparent. Në këtë drejtim, INDEP ofron asistencë në mbikqyrjen e agjencive të pavarura që prej 2012 me analiza të bëra për raportet vjetor të agjencive të pavarura.

Agjencitë funksionojnë në bazë të ligjeve të tyre të vecanta dhe njëherazi, raportojnë në bazë të specifikave që burojnë nga ato ligje. Në këtë rast, Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit e obligon AKP-në që të raportojë te Komisioni respektiv i Kuvendit për pikat si në vijim:

1. Bordi i dorëzon Kuvendit të Kosovës dhe e bën publik raportin vjetor të Agjencisë i cili duhet të përfshijë:

- 1.1.pasqyrat financiare të llogarive të Agjencisë;
- 1.2.veçmas nga llogaritë e Agjencisë, pasqyrat financiare të llogarive dhe asetëve të cilat mbahet nga Agjencia në mirëbesim;
- 1.3.listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë të Agjencisë në pajtim me nenin 6.1 të këtij ligji;
- 1.4.listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit për të cilin raportohet dhe për transaksionet e mbetura pezull;
- 1.5.listën e ndërmarrjeve të likuiduara sipas nenit 9; dhe
- 1.6.listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit<sup>1</sup>

Duke qenë se ky ligj Agjencisë i kërkon pika konsiderueshëm të gjera, INDEP-i, në bashkëpunim me Kuvendin, në vitin 2014 kanë krijuar “Manualin për Raportim të Agjencive të Pavarura në Kuvendin e Kosovës”.<sup>2</sup> Ky Manual lehtëson punën e monitorimit dhe gjithashtu krijon mundësi të reja për transparencë obligative të agjencive të pavarura. Agjencitë e Pavarura i përgjigjen Kuvendit, ndërsa raportet vjetore shërbejnë si vlerësues të punës së tyre. Manuali shton pika të reja që agjencitë duhet të raportojnë. Për AKP-në, Manuali parasheh që AKP-ja të raportojë edhe në mënyrë të përgjithshme lidhur me pikat që e obligon ligji në bazë të cilit funksionon. Shtuar tyre, pikat që Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të përfshijë në raportet vjetore janë:

- 6.1.1. Anekset e parashtruara tek komisioni i shqyrtimit. Kjo pjesë duhet të jetë pjesë integrale dhe e detajuar e raportit, duke mos përmbajtur vetëm lista, por edhe të dhëna të bashkangjitura.

<sup>1</sup>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, (2011), Ligji nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Neni 20, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2773> (qasur në maj, 2020)

<sup>2</sup> Manuali për Raportim të Institucioneve të Pavarura në Kuvendin e Kosovës. INDEP, 2014 [http://indep.info/wp-content/uploads/publikimet\\_sq/Manuali%20p%C3%ABr%20Raportim%20t%C3%AB%20Institucioneve%20t%C3%AB%20Pavarura%20n%C3%AB%20Kuvendin%20e%20Kosov%20C3%ABs%20%5BIndep%20C01%202014%20Qeverisje%20Demokratike%5D.pdf](http://indep.info/wp-content/uploads/publikimet_sq/Manuali%20p%C3%ABr%20Raportim%20t%C3%AB%20Institucioneve%20t%C3%AB%20Pavarura%20n%C3%AB%20Kuvendin%20e%20Kosov%20C3%ABs%20%5BIndep%20C01%202014%20Qeverisje%20Demokratike%5D.pdf)

- 6.1.2. Ndërmarrjet e shitura, transferuara dhe likuiduara, duke përfshirë përmbledhje të detajuara të valëve të privatizimit.
- 6.1.3. Ndërmarrjet që kanë dështuar për t'u privatizuar dhe arsyetimet përcjellëse.
- 6.1.4. Shqiptimin e gjobave.
- 6.1.5. Listën e banesave në autoritet të AKP-së.

Manuali, pas publikimit të tij, është dërguar te Agjencia me kohë dhe pritet që agjencitë e pavarura t'a konsultojnë atë Manual gjatë përpilimit raporteve vjetore dhe t'i përfshijë këto të dhëna. Raporti Vjetor i vitit 2019 i AKP-së ka përmirësime prej Raportit Vjetor 2018, por disa nga kërkesat e adresuara gati përvitshëm të AKP-ja nuk po përfillen. Të gjeturat janë të prezantuara më poshtë.

## Gjetjet nga raporti

Raporti i dorëzuar për punën e bërë gjatë vitit 2019 përmban 164 faqe. Fakt pozitiv në këtë raport është se raporti tek këtë vit, ndjek të njejtën frymë. Ndonëse fillimisht raporti është i ndarë sipas departamenteve, raporti këtë vit ka përmirësime të dukshme në përmbajtje. Kjo do të thotë që Agjencia i ka kushtuar rëndësi këtij aspekti. Por, ky raport i përvjetshëm as këtë vit nuk përmban disa kërkesa të përsëritura ndër vite.

Fillimisht, AKP ende nuk ka publikuar strategjinë e saj të veprimit. Viti i fundit kur kjo strategji

### Raportit i mungojnë:

1. Objektivat e punës për vitin 2019-2020, Strategjia e AKP
2. Plani për realizimin e shitjes së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore
3. Lista e ndërmarrjeve dhe aseteve për privatizim
4. Plani për vitin 2020
5. Lista e banesave me qira
6. Lista e shpronësimeve
7. Lista e NSh-ve në likuidim

është përmenduar ka qenë viti 2016, ndërsa tash jemi në 2020 dhe ende nuk është publikuar. Në webfaqen zyrtare të saj, e vetmja strategji figuron Strategjia e Njesisë për Auditim të Brendshëm për vitet 2020-2022, miratuar në mbledhjen e bordit të datës 23 dhjetor 2019. Është me interes të dihet se cka parasheh kjo strategji dhe të publikohen edhe Objektivat e punës për vitin 2019 dhe vitin e ardhshëm, 2020. Këto dokumente do të sqaronin se në cilën fazë gjendet Agjencia pasi që Agjencia nuk ka mandat të përhershëm. Ndërsa me mospublikimin e dokumenteve sipas të cilave Agjencia në fakt funksionon, përcaktimi i fazës së punës së saj është i pamundur. Agjencia, me mospublikimin e strategjive të saj, planit të veprimit, lë hapësira të mëdha për hamendje, pasi ajo as nuk ka publikuar dhe as nuk i ka bashkangjitur raportit vjetor Planin për realizimin e shitjes së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Listën e Ndërmarrjeve dhe

Aseteve për Privatizim dhe as Planin për vitin 2020. Dokumente tjera që mungojnë janë: **Lista e banesave me qira, Lista e shpronësimeve dhe Lista e NSh-ve në likuidim.**

Publikimi i dokumenteve të tilla qartëson punën, mandatin dhe misionin e qartë të Agjencisë. Procesi i privatizimit dhe puna e Agjencisë, pa paragjykuar, është shoqëruar shpesh edhe me debate lidhur me transparencën e proceseve dhe dyshime lidhur me të, prandaj këto dokumente janë mëse të nevojshme të bëhen publike. Në këtë pikë, Agjencia duhet patjetër të ketë të qartë fazën në të

cilën gjendet dhe kur parashihet të përfundojë puna e saj. Për të arritur këtë, publikimi i dokumenteve dhe strategjive në bazë të të cilave funksionon, është parakusht.

Tek misioni, problematik është fakti që raporti në mënyrë nominative thekson në faqen 12 që “Agjencia është e vendosur që **pa vonesa** të bëjë transformimin e pronës shoqërore krejt kjo me qëllim të zbatimit të mandatit të saj i cili buron nga Kuvendi i Kosovës. Rrjedhimisht AKP është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë e Kosovës si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose asetëve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues.” Pavarësisht se Agjencia ka miratuar Rregulloren për Qiradhënie<sup>3</sup>, fakti që Agjencia po praktikon dhënien me qira në vend të shitjes ose privatizimit, pos që e komprometon Agjencinë në pjesën e transparencës, pasi Agjencia nuk po publikon lista të qiradhënies, gjithashtu e largon nga misioni i saj primar, që është pikërisht shitja ose privatizimi.

Raportit i mungon Lista e banesave me qira. Lista për vitin 2019 nuk është e bashkangjitur në raport, por as nuk gjendet në web faqen e Agjencisë. Lista e banesave me qira dhe detajeve tjera të shfrytëzuesve ose përfitësve të këtyre banesave duhet të bëhet publike, sepse vetëm kështu Agjencia qartëson situatën me formën e shfrytëzimit të këtyre banesave. Asetet e dhëna me qira figurojnë sikur “lokalet, toka bujqësore, pikat e shitjes të derivateve, depot dhe të tjera”, pa ofruar asnjë specifikë për llojin e tyre. Ngjashëm sikur me listën e banesave me qira, në raportin për vitin 2019 të llogaritë e arkëtueshme, apo llogaritë që pritet / duhet të arkëtohen, figuron shifra 14,209,976 euro. Nuk shpjegohet saktë se kjo shifër a pritet të arkëtohet nga banesat e lëna në duar të uzurpatorëve, por se raporti as nuk përfshin pjesën e banesave të uzurpuara fare. Rrjedhimisht, kjo shifër duhet t’i takojë vlerës që do të mund të arkëtohej nga qiratë tash të uzurpuara. Departamenti Ligjor i Agjencisë nuk përmend ngritjen e padive ose hedhjes në gjyq të uzurpatorëve, gjë që është shqetësuese pasi shifra që paraqet humbje është e lartë.

Tek faqja e Agjencisë, figuron vetëm Lista e qirave të cilat janë të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së.<sup>4</sup> Nga objektet në qiradhënie, përpos rastit të Objektivit të Pallatit dhe Rinisë që ka qenë në kontekst, mungojnë arsyetimet për objektet e tjera. Prandaj, INDEP e sheh domosdoshmëri që të jepet arsyetim se pse po praktikohet qiradhënia nga një institucion i pavarur që në fakt ka kompetencë të bëjë shitjen e atyre objekteve. Gjithashtu, mospublikimi i listës lë vend për dyshime për favorizime subjektsh, meqenëse këto të dhëna nuk po bëhen publike. Kërkesa për publikimin e kësaj liste po bëhet tash e 7 vite.

Në webfaqen e Agjencisë, lista e sipërpërmendur, Lista e qirave të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve, nuk është përditësuar që prej datës së publikimit, në gjysmë të vitit 2018. Aktualisht, në listën që është e qasshme në webfaqe, vetëm 3 nga objektet e listuara figurojnë që kanë pasur kontratë deri në vitin 2019. Në vitin 2020 që jemi kur po flasim, të gjitha objekteve iu kanë skaduar

---

<sup>3</sup> Rregullore për qiradhënien e asetëve të ndërmarrjeve shoqërore. AKP, 2019 <http://www.pak-ks.org/desk/inc/media/24265BD3-4C10-48C7-BAEE-73E7387901B5.pdf>

<sup>4</sup> <http://www.pak-ks.org/desk/inc/media/0670AE7F-2FC1-4D74-9993-4E89776D7B4D.pdf>

kontratat. Raporti nuk përfshin as atë listë të dalë afati dhe as listën e re, nëse ka. INDEP konsideron që ky është element shumë me rëndësi në rritjen e transparencës. Vlera e raportuar totale e objekteve në qira është 5,462,436 euro. Raportimi i plotë i AKP është obligim ligjor.

AKP ka në posedim edhe banesa. Kontrata për shitjen e banesave të nënshkruara në raport është 14 por nuk bëhen të ditura tjera detaje. Publikimi i detajeve të këtyre kontratave është interes i publikut pasi nuk dihen termet e nënshkrimit të këtyre kontratave. Gjithashtu, AKP ka edhe banesa të uzurpuara, por që të dhënat e uzurpatorëve nuk po bëhet publike dhe as a po merren hapa ligjorë në këtë drejtim.

Tek qiratë e inkasuara nga ndërmarrjet në likuidim, nga gjithsej 3,787,605 euro prej tyre 1,192,323 euro janë të evidentuara sikur “NSh Tjera në Likuidim”. Kjo i ble që 1/3 e vlerës mbeten NSh anonime dhe jo të bëra publike. “Të tjera” është term i përdorur shpesh në raportimet e Agjencisë. Një cilësim dhe përgjithësim i tillë i përdorur nga Agjencia është i papranueshëm, duke ditur që transparenca është faktor kryesor që kërkohet nga agjencitë e pavarura.

Agjencia në raportin e vitit Agjencisë nga Ligji i buxhetit për vitin 2019 i lejohet të punësojë gjithsej 258 zyrtarë, ndërsa numri aktual i punëtorëve në fund të vitit 2019 figuron të jetë 247 zyrtarë. Mosshfrytzimi i mundësive maksimale mund t’u pengojë Agjencinë të arrijë kapacitetet e saj optimale dhe rrjedhimisht t’u ngadalësojë punën e saj. AKP ka publikuar organogramin e saj, por meqenëse rëndësia e Agjencisë është e madhe, INDEP e sheh me rëndësi të publikohet edhe numri i të punësuarve në sektore. Nga kjo, vërejtje tjetër del se raporti vjetor në raste vërehet se nuk ka pasur “proof-read” sepse tek-tuk hasen gabime të cilat nuk dihet a janë teknike apo të qëllimshme. Shembull, numri i kontratave të dorëzuara deri në fund të vitit 2019 në tekst paraqitet si 84, ndërsa në tabelë sikur 86. Gabime të tilla krijojnë pasaktësi dhe konfuzion për këdo që e lexon raportin vjetor, vecanërisht për deputetët që do t’u votojnë, por gjithashtu prezanton edhe informata të rreme pasi gjithsesi që njëra shifër është jo e vërtetë. Informatat e rreme gjithashtu dënohen me ligj.

Shifrat e mospërputhshme vazhdojnë edhe më tej, specifíkisht tek seksioni i aseteve të mbetura (të pashitura) me të cilat administron AKP-ja, gjithsej 2,231 në tekst. Ndërsa asetet jashtë Kosovës shprehet se janë 163 asete të Ndërmarrjeve Shoqërore pa i përfshirë asetet e Trepçës. Numri në tabelën më poshtë për të njëjtat ndryshon, duke u shndërruar në total 2,437, ndërsa totali i shifrave në tekst është 2,394. AKP duhet gjithsesi të japë sqarime shtesë se si kalkulohen në tekst dhe si në tabela nëse dallimi qëndron këtu, si dhe nëse ka ndonjë arsye pse shifrat nuk përputhen me raste. Lista e këtyre aseteve mungon gjithashtu.

Gjithashtu tek resurset njerëzore, Ligji nr. 06/L-111 Për Pagat në Sektorin Publik<sup>5</sup> i cili tash është i pezulluar dhe në Gjykatën Kushtetuese deri në qershor 2020, nuk përmendet fare në raport. Ky ligj në mënyrë të drejtpërdrejtë parashihet të ndikojë në Agjenci. Duke ditur se Raporti Vjetor dërgohet në Kuvend dhe Ligji për Paga buron nga Kuvendi, injorimi i përmendjes së tij në raport

---

<sup>5</sup> Ligji Nr. 06/L-111 Për Pagat Në Sektorin Publik. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18683>

është i paqartë. Të paktën, ky raport do të duhet të përfshinte planifikimin buxhetor për paga, bazuar në ndryshimet që do t'i sjellë Ligji për paga pas kthimit nga Kushtetuesja.

Tek seksioni Departamenti Ligjor i Agjencisë figurojnë të dhëna që Agjencia ka departamentin e saj ligjor, i cili i ka nën menagjim çështjet ligjore. Pavarësisht, Agjencia ka dy raste arbitrazhi në gjykata ndërkombëtare, një në Hagë dhe një në Hamburg në të cilat nuk po përfaqësohet nga ky departament. Raporti thotë se për dy raste të njejta, proceset e ndjekura janë të ndryshme. Në rastin e arbitrazhit në Hagë, AKP-ja thotë që ka zhvilluar procedurat, por që nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht tenderim publik për përzgjedhjen e “kompanisë së njohur nga SHBA”, sic referohet në Raportin Vjetor 2019. Publikimi i emrit dhe të dhënave të kompanisë, vlerës së kontratës dhe detaje tjera janë të nevojshme në mënyrë që procesi të jetë kredibil. Ndërsa, në rastin e paditjes në Hamburg, AKP ka shpallur tender publik për përfaqësim në arbitrazh. Pasiqë vlerat e padive janë milionëshe, respektivisht 9.4 dhe 18 milionë euro, detajet e këtyre proceseve është shumë me rëndësi të bëhen publike. Paratë që mund të humbasin nga këto procese janë para publike, për të cilat llogaridhënia është jo përgjegjësi, por obligim ligjor.

Arsye edhe më e madhe për publikimin e detajeve me kontratën e lidhur kompaninë në SHBA, por edhe me kompaninë që do të vijë nga tenderi në proces është se AKP në të kaluarën ka pasur histori dështimi në procese gjyqësore, të cilat kanë shkaktuar humbje financiare dhe dëmtim të parasë publike. Njëherazi, Departamenti Ligjor figuron që përfaqëson AKP-në në procese gjyqësore, por që nuk shpjegohet pse po angazhohen kompani të huaja në vend të stafit. Shtuar këtu, Agjencia raporton se ka pasur shpenzime në vlerë 8,400 euro si “Pagesa ndaj Ofruesit të Shërbimeve për këshilla ligjore”. Shpenzime të tilla kur në fakt Agjencia është mangu afër 10 punëtorë nga sa ia lejon ligji, janë të pamenduara mirë nga menagjimenti.

Departamenti Ligjor thuhet që merret me mbrojtjen e interesave të AKP-së, por në aneksin nr 19. Ndëshkimet ndaj NSh-ve me Spin-off Special Raporti thotë se në vitin 2019 nuk janë aplikuar ndëshkime lidhur me procesin e shitjes, as ndëshkime tjera për listën e aseteve të cekura në raport dhe se situata vazhdon njëjtë sikur në vitin 2018, pa dhënë arsye pse. Dëmi nga këto Nsh është milionësh, ndërsa arsyetimi pse nuk po merren masa ose pse spo aplikon ndëshkime, mungon.

Raporti i vitit 2019 vërtetë se përmban më shumë të dhëna se raportet e viteve të kaluara, por as këtë vit nuk është bashkangjitur lista me vendimet për shpronësime. Vendime të Shpronësimeve raportohen të jenë bërë për 978 asete ndërsa nga shpronësimi i aseteve të NSh-ve vlera e arkëtueshme e tyre raportohet të jetë 324,156 euro. Vendimet dhe arsyet për shpronësim nuk janë bashkangjitur në raport. Vecanërisht arsyet për shpronësim janë vendimtare në këtë proces, që të shmangen të gjitha dyshimet për favorizime, padrejtësi ose dëmtime ndaj subjekteve.

Sa i takon Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në likuidim, numri i tyre në raport figuron të jetë 20 për periudhën janar-dhjetor 2019. As kjo listë nuk është e bashkangjitur. Konsideruar që Agjencia i posedon këto lista, publikimi i tyre mbetet peng i gatishmërisë ose jo të tyre për t'i ndarë këto lista me publikun.



Gjithashtu, krahasimi i punës me vitet paraprake, është përmirësuar, por ende nuk e ka arritur gjendjen e kënaqshme. AKP duhet të përmirësojë ende qasjen e saj krahasimore mes viteve paraprake.

## **Përfundime dhe rekomandime**

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka vite që i kërkohen të publikojë lista. Dërgimi i raportit në këtë formë, në të cilin përfshihen shumë shifra, por pak emra e lista vetëm sa krijon më shumë konfuzion dhe rrit mundësitë për jotransparencë. Sqarime, emra, të dhëna, lista janë domosdoshmëri për t'iu bashkangjitur raporteve vjetore nga ana e Agjencisë. Gjithashtu, raporti pavarësisht që është voluminoz sepse puna e Agjencisë është me itensitet të lartë, të gjitha të dhënat duhet të kenë përputhshmëri mes vete.

Kur Agjencisë i kërkohet raportimi, duhet të bëhet e qartë që nuk mund të raportojnë në formë numrash, pa ofruar lista me të dhëna dhe me detaje. Kjo praktikë e AKP-së në fakt sa e vështirëson monitorimin e saj dhe krahasimet mes viteve të ndryshme janë të pamundura. Rekomandohet që AKP-ja gjithashtu t'a heqë kategorinë “të tjera”, e cila krijon hapësira për mbulime të dhënash ose edhe manipulime.

AKP patjetër duhet të publikojë planin e saj të punës, strategjinë sipas së cilës funksionon, listat e aseteve të planifikuara për 2020, si dhe të sigurohet që të ndjekë objektiva të qarta. Vetëm kështu, puna e AKP ka gjasë që të ketë plan veprimi dhe të ketë mundësi të zbatojë objektivat që i vendos për vitin e punës. Në formën si funksionon kjo agjenci, rruga e saj duket e paqartë, ndërsa sa më e gjatë puna e Agjencisë, aq më shumë humbje potenciale për arkëtim në buxhet, kur dihet se funksionimi i AKP-së është ndër më të kushtueshmit për buxhetin e vendit, mes agjencish.

Kjo analizë ka identifikuar një numër listash të cilat nuk janë të bashkangjitura. Listat e lartcekura tek të gjeturat e raportit nuk janë bashkangjitur dhe as bërë publike ndonjëherë, madje që prej themelimit të Agjencisë. Agjencia e ka përgjegjësi që të sigurohet që transparenca të jetë e lartë nga ana e saj. INDEP rekomandon që të gjitha listat e mësipërme të bëhen publike.

Lista e banesave që i ka në pronësi duhet të bëhet publike. Sidomos kur dihet që vlera e banesave varet nga lokacioni ku gjendet ato, detajet e tjera përkatëse duhet të bashkangjiten gjithashtu.

Lista e ndërmarrjeve dhe aseteve për privatizim ka mbetur e papublikuar tash e sa vite. AKP cdo vit raporton për asete të reja që i merr në pronësi të veten, pa dhënë shpjegime se pse ato nuk janë marrë më herët nën menagjimin e saj. Rrjedhimisht, shifrat e ndërmarrjeve dhe aseteve të mbetura për privatizim janë gjithmonë në ndryshim e sipër.

Raportit nuk i është bashkangjitur as Lista e Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në likuidim. Lista me të dhënat e këtyre ndërmarrjeve gjithashtu është me interes.

Uzurpimi i banesave është dëmtues i buxhetit të AKP-së. AKP nuk publikon listën e uzurpatorëve të banesave dhe as nuk po ndërmerr veprime ligjore. Departamenti Ligjor i AKP-së e ka obligim

që të merret dhe të krijojë zgjidhje nga kjo situatë pasi humbjet e AKP-së janë edhe humbje të buxhetit të shtetit.

Mes listash që mungojnë, është edhe lista e shpronësimeve. Raporti përfshin shifrën se sa vendime për shpronësim janë marrë por as nuk jep arsye, as listë. Kjo është madje edhe e rrezikshme, pasi nëse nuk bëhen të ditura arsyet e shpronësimit, vihet në rrezik edhe interesi i qytetarëve dhe mund të dëmtohen në favor të Agjencisë palët e tjera, përfshirë këtu qytetarët.

Kërkesë e përsëritur është që AKP-ja të raportojë për shqiptimin e gjobave, por AKP-ja në fakt as nuk ka marrë pozitë paditëse. Në shumë raste, AKP është vetë pala që paditet. INDEP rekomandon që AKP të fillojë sa më shpejt me shqiptimin e gjobave në rastet që kërkohet, e vecanërisht në rastin e uzurpatorëve të banesave.

Publikimi i të gjitha listave tjera të evidentuara më lartë se mungojnë do të rrisnin nivelin e transparencës së punës së AKP-së, pasi që forma se si AKP-ja raporton lë shumë për të dëshiruar. Sidomos, kjo bëhet edhe më shqetësuese kur kihet parasysh se kjo është mënyra e vetme e llogaridhënies nga kjo Agjenci, e cila e ka shumë të vështirë të ndajë të dhëna.

Rekomandim i përsëritur për Agjencinë është që të shpjegohet lidhja mes buxhetit të saj dhe planit të veprimit. Kjo lidhshmëri është e nevojshme sepse edhe do t'ua lehtësonte punën e Agjencisë dhe gjithashtu do të arrinte që buxheti të shpenzohet në pajtim me synimet e Agjencisë. Buxheti i Agjencisë si i tillë është mjaft i lartë dhe efektiviteti i Agjencisë nëse proporcionohet me buxhetin që e ka në dispozicion, rezultati nuk është i kënaqshëm.

Përgjithësisht, Raporti Vjetor ka përmirësime nga vitet e kaluara, por se rekomandimet specifike nga vitet e kaluara për rritje transparence nuk janë përfillur nga Agjencia as këtë vit.

## Lista e Kontrollit me Elementet e Raportit

(Bazuar në Manualin e Kuvendit dhe INDEP për Raportim të Institucioneve dhe Agjencive të Pavarura)

		Po	Jo	N/A	Koment
<b>Forma e Përgjithshme e Raportit</b>					
<b>1</b>	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>				
	a. Pikave kryesore të cilat elaborohen në raport	Po			
	b. Arritjet e agjencisë për vitin e raportimit	Po			
	c. Objektivat për vitin e ardhshëm		Jo		
<b>2</b>	<b>Baza Ligjore, Permirosimet dhe Veshtiresite</b>				
	a. Ligjet, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të institucionit	Po			
<b>3</b>	<b>Përshkrimi i Institucionit</b>				
	a. Misioni / Vizioni dhe Kompetencat	Po			
	b. Departamente përgjegjëse për plotësimin e detyrave kryesore që i përkasin kompetencave	Po			
<b>4</b>	<b>Organizmi institucional</b>				
	a. Raportimi për organizimin e brendshëm të institucionit (bordi, ekzekutivi, deri te personeli)	Po			
	b. Puna e bordit gjatë vitit raportues	Po			
	c. Organogrami; Hapesira fizike dhe lokacionit; Deklarimi I mungeses se infrastruktures se nevojshme fizike	Po			Nuk jepen detaje
	d. Asetet	Po			Nuk jepen detaje

<b>5</b>	<b>Përshkrim i Tregut/Fushën që e mbulon institucioni</b>				
	a. Krahasimi me vitin paraprak	Po			
	b. Sfidat e vitit raportues dhe planifikimi për vitin vijues		Jo		Mungon plani për vitin 2020
<b>6</b>	<b>Puna gjatë vitit paraprak</b>				
	a. Punet specifike që agjencia i ka bërë gjatë vitit raportues	Po			
	b. Detyrat dhe përgjegjësitë konform ligjit	Po			
	c. Sa janë arritur qëllimet e parapara nga viti paraprak (te arsyetohen ato që nuk janë arritur)		Jo		Mungojnë planet vjetore 2018 dhe 2019
<b>7</b>	<b>Raporti financiar</b>				
	a. Raporti i buxhetit me shpenzime	Po			
	b. Të ndahen rrogat nga mëditjet	Po			
	c. Ndikimi i buxhetit në punën e Institucionit	Po			
	d. Planifikimi / Realizimi i buxhetit	Po			
	e. Investimet kapitale	Po			
	g. Shpenzimet buxhetore në bazë të aktiviteteve	Po			
	h. Vizitat jashtë vendit, mëditje, akomodim, numri i udhëtimeve dhe personave që kanë marrë pjesë	Po			Të dhënat nuk janë të detajuara
<b>8</b>	<b>Raportimi rreth komenteve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm</b>				

	a. Tabela duhet paraqitur me komentet dhe rekomandimet e ZAP dhe niveli i zbatueshmërisë së tyre nga ana e institucionit	Po			
<b>9</b>	<b>Anekset</b>				
	a. listën e ndërmarrjeve që janë vënë nën administrimin e drejtpërdrejtë	Po			
	b. listën e ndërmarrjeve të likuiduara	Po			
	c. listën e transaksioneve të kryera sipas nenit 8 të realizuara gjatë vitit	Po			
	d. listën e ndërmarrjeve ndaj të cilave është filluar procedura e riorganizimit	Po			Jepen shifrat për vlerën totale por nuk jepet lista
	e. lista e asetëve të mbetura të pa privatizuara		Jo		
	f. listën e banesave në autoritet të AKP-së.		Jo		
<b>Specifikat e Raportimit</b>					
<b>10</b>	Shqiptimi i gjobave			N/A	Nuk përmenden fare
<b>11</b>	Ndërmarrjet që kanë dështuar për t'u privatizuar dhe arsyetimet përcjellëse	Po			
<b>12</b>	Ndërmarrjet e shitura, transferuara dhe likuiduara, duke përfshirë përmbledhje të detajuara të valëve të privatizimit	Po			Nuk jepen detaje